

Shkollat Tona. E Ardhmja Jonë: Biseda me Kancelarin



Të nderuar anëtarë të komunitetit të NYCPS,

Jeni të ftuar t'i bashkoheni

Kancelarit Kamar H. Samuels

për një seri bisedash të drejtpërdrejta në mbarë qytetin e New York City (Nju-Jorkut), të cilat do të fokusohen tek e ardhmja e shkollave tona publike.

Shkollat Tona. E Ardhmja Jonë: Biseda me Kancelarin

është një seri angazhimi në nivel qyteti që bashkon nxënës, familje, mësues, anëtarë stafi dhe partnerë të komunitetit për dialog të hapur dhe të ndershëm mbi situatën aktuale të shkollave tona dhe çfarë duhet arritur më tej.

Nëpërmjet dhjetë ndalesave në çdo cep të qytetit, Kancelari Samuels do të angazhohet drejtpërdrejt me komunitetet për të diskutuar se si janë në praktikë siguria, rigoroziteti akademik dhe integrimi i vërtetë, si edhe mbi mënyrat se si mund ta forcojmë sistemin tonë për vitet e ardhshme. Këto biseda janë konceptuar për të nxjerrë në pah përvojat e jetuara, për të identifikuar prioritetet e përbashkëta dhe për të informuar planet e hershme të Kancelarit për NYC Public Schools (Shkollat Publike të NYC)-së. Kjo do të jetë gjithashtu një mundësi që familjet të ndajnë ide për përmirësimin e fuqizimit të familjeve në NYCPS, duke siguruar që zërat e familjeve dhe të komunitetit të dëgjohen.

Ju lutemi regjistrohuni përmes lidhjes së mëposhtme:

on.nyc.gov/ChancellorConversationsAL

Kjo do të jetë një hapësirë për dialog të rëndësishëm dhe reflektim kolektiv, në mënyrë që të mund të formësojmë së bashku të ardhmen.

Në bashkëpunim,
New York City Public Schools
(Shkollat publike të qytetit të Nju-Jorkut)

Shkollat Tona. E Ardhmja Jonë: **Biseda me Kancelarin**



Bashkohuni me Kancelarin Kamar H. Samuels në biseda të drejtpërdrejta me komunitetin në mbarë New York City (Nju-Jorkun) për të diskutuar rreth të ardhmes së shkollave publike.

Të mbështetura në vizionin e Kancelarit, këto biseda do të përqendrohen te siguria, rigoroziteti akademik dhe integrimi i vërtetë, duke fuqizuar njëkohësisht familjet dhe duke vënë në qendër zërin e komunitetit.

REGJISTROHUNI TANI

[on.nyc.gov/
ChancellorConversationsAL](https://on.nyc.gov/ChancellorConversationsAL)



**Dhjetë
ndalesa.
Një qytet.
Një e ardhme.**

| Data/ora | Vendndodhja |
|---------------------------------|---|
| 10.2.2026 18:30-20:00 | Staten Island New Dorp High School 465 New Dorp Lane, Staten Island, NY 10306 |
| 24.2.2026 | Është shtyrë më 23.3.2026 |
| 28.2.2026 10:30-12:00 | Brooklyn Thomas Jefferson Educational Campus 400 Granville Payne Avenue, Brooklyn, NY 11207 |
| 7.3.2026 10:30-12:00 | Queens Beach Channel Educational Campus 100-00 Beach Channel Drive, Rockaway Park, NY 11694 |
| 10.3.2026 18:30-20:00 | Bronx Albert Tuitt, Sr. Educational Campus 921 East 228th Street, Bronx, NY 10466 |
| 14.3.2026 10:30-12:00 | Manhattan Martin Luther King, Jr. Educational Campus 122 Amsterdam Avenue, New York, NY 10023 |
| 17.3.2026 18:30-20:00 | Queens Queens Innovation Center 53-16 Northern Boulevard, Queens, NY 11377 |
| 23.3.2026 18:30-20:00 | Manhattan Manhattan Center for Science and Mathematics 260 Pleasant Avenue, New York, NY 10029 |
| 24.3.2026 18:30-20:00 | Brooklyn John Dewey High School 2471 Stillwell Avenue, Brooklyn, NY 11223 |
| 28.3.2026 10:30-12:00 | Bronx Roosevelt Educational Campus 500 East Fordham Road, Bronx, NY 10458 |
| 25.4.2026 10:30-12:00 | Staten Island (Data e re!) Curtis High School 105 Hamilton Avenue, Staten Island, NY 10301 |